



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RREGULLORE
PER
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE KOMUNITARE TE
BASHKISE TROPOJE
(Kryetar/Kryesi Fshati)

Kreu I

Kjo rregullore eshte hartuar ne baze te ligjit Nr.139/2015, te miratuar me date 17.12.2015 "Per vetqeverisjen vendore", nenet 8/2, 9/1/1.1/b, 54/k, 70, 71, ligjin Nr.44/2015, te miratuar me date 30.04.2015 "Kodi i Proçedurave Administrative ne Republiken e Shqiperise" si dhe ligjit Nr.115/2014, te miratuar me date 31.07.2014 "Per ndarjen administrative-territoriale te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise", duke patur si qëllim rregullimin e veprimtarisë se strukturave komunitare (nendarjeve) për ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave.

Neni 1

Brenda hapësirës së normave, kriterëve dhe standardeve të pranuar me ligj, Bashkia Tropoje do të organizojë procedurat për zgjedhjen e strukturave të nendarjeve administrative sipas kërkesave dhe afateve ligjore. Numri i strukturave komunitare (nendarjeve administrative) paraqiten në listën e veçantë shtojca Nr.1, pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 2

Organizimi dhe procesi i zgjedhjes se strukturave komunitare

Administratoret e Njesive Administrative marrin te gjitha masat për organizimin e procedurave për zgjedhjen e strukturave komunitare (Kryetar dhe Kryesi Fshati). Keshilli Bashkiak ndjek procedurat për zgjedhjen e strukturave komunitare.

Njesia Administrative informon te gjithë shtetasit te cilet kane te drejte vote për organizimin e procedures se zgjedhjeve te struktures administrative, me ane te:

- Njoftimeve publike, i cili përmban datën, orën si dhe vendin e organizimit të mbledhjes.
- Faqen zyrtare të internetit të bashkise

Neni 3

Kryetari i Fshatit

Kryetari i Fshatit zgjidhet nga radhët e Kryesisë së Fshatit me votim të fshehtë me jo më pak se 2 (dy) kandidatura. Zgjedhjet e Kryetarit të Fshatit bëhen një herë në 4 (katër) vjet pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj pas këtyre zgjedhjeve. Në rast mosrespektimi të këtij afati, deri në zgjedhjen e Kryesisë së Fshatit, Kryetari i Bashkisë emëron përkohësisht Kryetarin e Fshatit.

Neni 4

Zgjedhja e Kryetarit të Fshatit

Proçesi i zgjedhjes të Kryetarit të Fshatit, organizohet nga Njësia Administrative sipas rregullave dhe menyrave të votimit të miratuara nga Këshilli Bashkiak.

- a. Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e Kryetarit të Fshatit fillimisht paraqitet dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatëve.
- b. Zgjidhet një komision votimi, si rregull me 3 (tre) anëtarë.
- c. Komisioni i votimit drejton të gjitha proçedurat deri në shpalljen e kryetarit, plotëson fletë-votimet dhe përcakton rregullat e votimit.
- d. Votimi bëhet i fshehtë dhe pas votimit hartohet proçes-verbali nga komisioni dhe shpallet kryetari i zgjedhur.

Neni 5

Zgjedhja e Kryesisë së Fshatit

Anëtarët e Kryesisë së Fshatit zgjidhen në mbledhjen e fshatit, me shumicën e votave të pjesëmarrësve, me të drejtë vote, në mbledhje. Në rastet kur fshati përbëhet nga disa lagje, secila nga lagjet zgjedh një anëtar kryesie. Mënyrat dhe rregullat e votimit përcaktohen nga Këshilli Bashkiak. Në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e Kryesisë së Fshatit, paraqitet dhe bëhet një prezantim i shkurtër i kandidatëve.

- a. Zgjidhet një komision votimi, si rregull me 3 (tre) anëtarë.
- b. Komisioni i votimit drejton të gjitha proçedurat, plotëson fletë-votimet dhe përcakton rregullat e votimit.
- c. Votimi bëhet i fshehtë dhe pas votimit hartohet proçes-verbali nga komisioni dhe shpallet përberja e Kryesisë së Fshatit.

Zgjedhja e Kryesisë së Fshatit bëhet një herë në katër vjet pas zgjedhjeve për Këshillin Bashkiak dhe jo më vonë se 3 (tre) muaj pas këtyre zgjedhjeve.

Neni 6

Perfundimi i mandatit të anëtarit dhe Kryetarit të Kryesisë së Fshatit

6.1. Mandati i antarit dhe Kryetarit të Kryesisë së Fshatit përfundon përpara afatit në rastet kur:

- a. jep dorëheqjen;
- b. nuk është më banor i përhershëm i njësise administrative,
- c. humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate të formës së prerë;
- d. shkarkohet nga detyra

- e. vdes.
- 6.2. Antari dhe Kryetari i Kryesise se Fshatit në rastet e dorëheqjes, e depoziton kerkesen pranë Njesise Administrative.
- a. Për ndjekjen e procedurave të nevojshme, Administratori i Njesise Administrative, njofton brenda 3 (tre) diteve Kryetarin e Bashkise për aktin e dorëheqjes.
 - b. Me përfundimin para kohe të mandatit të Kryetarit të Kryesise se Fshatit, deri në zgjedhjen e kryetarit të ri, funksionet e tij i kryen nje antar i Kryesise se Fshatit.
 - c. Nëse rastin kur qytetarët e konsiderojnë që Kryetari ose anëtarët e Kryesise se Fshatit nuk i kanë përmbushë detyrimet ligjore, ata mund të shkarkohen me shumicën e votave të banorëve të fshatit.
 - d. Kjo procedure do te zbatohet ne rastin e paraqitjes se nje mocioni mos-besimi i cili duhet te permbaje nënshkrimet e më shumë se gjysmes se numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur struktura perkatese (Kryetar ose antari i Kryesise se Fshatit).
 - e. Kryetari i Fshatit ne çdo rast nese largohet nga detyra, duhet te beje paraprakisht te gjitha veprimet e duhura per dorezimin e vules dhe dokumentacionit tek Administratori i Njesise Administrative.
 - f. Në rastet e krijimit të vendit vakant për Kryetarin e Fshatit ose për anëtar të Kryesisë zhvillohen procedurat e zgjedhjes për vendin vakant, sipas percaktimit te bere ne nenet 4 dhe 5. Mandati i të zgjedhurit të ri vazhdon deri në përfundim të periudhës së mbetur të afatit katërvjeçar.

Kreu II

Neni 7

Roli dhe pergjegjesite

Mbështetur në aktet ligjore/nënligjore si dhe në rregulloren e funksionimit te strukturave te nenndarjeve te bashkise, Kryetari dhe antaret e Kryesise se Fshatit kane pergjegjesi per të vepruar dhe për të punuar në bazë të parimeve të profesionalizmit, paaënisisë politike, transparencës, dhe korrektësisë në zbatimin e detyrave

- a. Kryetari i Fshatit nënshkruan të gjitha aktet e Kryesisë së Fshatit, si dhe proces-verbalet e mbledhjeve të Kryesisë.
- b. Kryetari i Fshatit siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit të Bashkise dhe të Kryesisë së tij.

Neni 8

Detyrat dhe të drejtat e Kryetarit dhe të Kryesisë së Fshatit

- 8.1. Kryetari dhe Kryesia e Fshatit kryejnë dhe mbështesin funksionet qeverisëse të Bashkisë në fshatin e tyre, si dhe kujdesen për zhvillimin ekonomik, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale.
- 8.2. Bazuar ne vendimin e Kryetarit te Bashkise, Kryetari ose Kryesia e Fshatit mund të kryejnë edhe detyrat e meposhtme:

- a. Kujdesen për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm;
- b. Marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha, të ujërave të zeza, kanaleve mbrojtëse të zonave të banuara si dhe si dhe rrjetit të kanaleve tretësore të ujitjes dhe kullimit;
- c. Marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloji dëmtimi në rrugët, trotualet dhe sheshet publike të fshatit;
- d. Administrimin e varrezave të fshatit;
- e. Administrimin e lulishteve dhe të zonave të gjelbëruara publike;
- f. Kujdesen për ruajtjen e pyjeve, të kullotave dhe të burimeve natyrore;
- g. Hartimin dhe propozimin e akteve lidhur me gjendjen sociale dhe të dhenave të personalitetit të banorëve të fshatit;
- h. Detyrat e tjera të parashikuara në rregulloret dhe urdheresat e Këshillit Bashkiak;

Neni 9

Aktet Administrative

Aktet administrative (vendime, urdhëra, shkresa) janë ato akte që nxirren në ushtrim të funksioneve dhe kompetencave dhe që kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial të nëndarjes.

- a. Çdo akt i miratuar nga Kryetari, Kryesia e Fshatit duhet të përmbajë, arsyetimin për nxjerrjen e aktit, shpjegimin e kuptimit të aktit, bazueshmërinë ligjore të tij, faturën financiare nëse ka, personin, institucionin/organizatën të cilës i drejtohet, personat apo strukturat e ngarkuara për zbatimin e aktit, momentin e hyrjes në fuqi të aktit etj.
- b. Kryetari i Fshatit ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët ose nga çdo institucion tjetër, në përputhje me ligjin.
- c. Urdhëresat, vendimet dhe urdhrat e organeve të zgjedhura të bashkisë, janë të detyrueshme për zbatim nga Kryetari dhe Kryesia e Fshatit.

Neni 10

Proçes-Verbalet e mbledhjeve të Kryesise së Fshatit

Proçes-verbalet e mbledhjeve të Kryesise së Fshatit kanë të gjitha elementët e dokumenteve të brendshme. Proçes-verbalet e mbledhjeve nënshkruhen nga mbajtësi i tij dhe Kryetari i Fshatit.

Neni 11

Dorezimi i dokumentacionit

Kryetari i Fshatit në fund të çdo viti, në bazë të regjistrit të korespondencës, bën dorezimin e dokumentacionit shkresor origjinal (të krijuar/të ardhur) në Njesinë Administrative.

Neni 12
Përdorimi i Vulës

Kryetari i Fshatit pajiset me vulë zyrtare (38 mm) cila e identifikon në aktet administrative të nxjerra prej tij.

- a. Kryetari i Fshatit ka autoritetin të lëshojë vërtetime për fakte e të dhëna për banorët ose territorin e fshatit të tij, për të cilat ai është në dijeni, sa herë që kjo kërkohet nga bashkia, nga vetë banorët, ose nga çdo institucion tjetër në përputhje me ligjin.
- b. Vula zyrtare përdoret vetëm për dokumente që kanë datë, numër protokolli dhe janë të firmosura nga Kryetari i Fshatit.
- c. Në rastet e humbjes së vules, njoftohet menjehere Bashkia Tropoje dhe Komisarjati i Policisë, si dhe merren të gjitha masat për zëvendësimin e vules sipas procedurës ligjore.

Neni 13
Hyrja ne fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas konfirmimit të vendimit nga institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

SEKRETARI
Ergent GJONGECAJ

KRYETARI KESHILLIT
Shotë BASHAJ



Shtojca Nr.1

Numri i strukturave komunitare (nendarjeve administrative)

| Nr. | Njësi te qeverisjes vendore | | | Qendra e Bashkisë | Njesite administrative perberese | Qytete dhe Fshatrat ne përbërje te saj |
|-----|-----------------------------|-----------------|---------|-------------------|----------------------------------|--|
| | Qarku | Qendra e Qarkut | Bashkia | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 1 | Tropoje | Tropoje | Tropoje | Qyteti B.Curre | Bashkia Tropoje | Qyteti B.Curre |
| | | | | | Bujan | Fshatrat: Bujan,Bllate,Dojan,Gri e Re,Lekurtaj,Markaj,Rosuje,Selimaj |
| | | | | | Margegaj | Fshatrat: Margegaj,Brodzhnic,Cerem,Dragobia,Fush-Lumi,Kocanaj,Paqe,Rrogami Shoshan Valbona |
| | | | | | Llugaj | Fshatrat: Llugaj,Bukove;Jaho Salihi,Luzhe,Rrogam,Rreze -Mali |
| | | | | | Tropoje | Fshatrat:Aste,Babine,Begaj,Bucaj,Gegaj,Hasaj,Kasaj,Kerrnaje,Kocane,Koje Kovac,Mejdan,Myhejan,Papaj,Sopot,Shkelzen,Shumice,Tropoje,Vicidol. |
| | | | | | Bytyc | Fshatrat:Berishe,Bytyc,Corraj,Velic,Kam,Kepenek,Leniq,Mashe,Pac,Prush,Visoca,Vlad,Zogaj, Zherke. |
| | | | | | Fierze | Fshatrat: Fierze,Tpla, Dushaj,Dege,Breglume |
| | | | | | Lekbibaj | Fshatrat: Lekbibaj,Betosh,Brise,Curraj I Poshtem,Curraj i siperm,Gjonpepaj,Palce,Peraj,Qerec,Mulaj,Salce,Shengjergj,Tetaj |

Administrimi i Lagjes

Në rastin e krijimit të lagjeve, krijohet dhe funksionon administrata e lagjes, që drejtohet nga administratori i lagjes. Administratori i lagjes emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Bashkisë. Nëpunësit e tjerë të administratës trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil. Administrata e lagjes kryen të gjitha detyrat administrative të ngarkuara nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak, si dhe kujdeset për zhvillimin ekonomik, për përdorimin e burimeve të përbashkëta dhe sigurimin e harmonisë sociale në lagjen përkatëse.

Kryetari dhe Këshilli Bashkiak, për të realizuar funksionet e veta, mund t'i ngarkojnë administratorit të lagjes detyrat e mëposhtme:

- kujdesin për parandalimin e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm;
- marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme në sistemin e kanalizimeve të ujerave të bardha, të ujerave të zeza;
- marrjen e masave në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme dhe të çdo lloj dëmtimi në rrugët, trotualet dhe sheshet publike;
- administrimin e lulishteve dhe të zonave të gjelbëruara publike;

- e. marrjen e masave për grumbullimin dhe largimin e mbeturinave;
- f. Hartimin dhe propozimin e akteve lidhur me gjendjen sociale dhe te dhenave te personalitetit te banoreve te lagjes;
- g. ndjek procedurat e zgjedhjes se organeve si dhe menyren e administrimit te bashkepronesise ne ndertesat e banimit sipas kerkesave te percaktuara ne ligjin Nr.10 112, date 09.04.2009 "Per administrimin e bashkepronesise ne ndertesat e banimit";
- h. detyrat e tjera te parashikuara ne rregullore e Këshillit Bashkiak;
- i. a) është zyrë e shërbimit për të gjitha procedurat administrative në kompetencën e bashkisë;
- j. b) mbikëqyr territorin për zbatimin e ligjit në të gjitha fushat në kompetencën e bashkisë dhe njofton strukturat kompetente të bashkisë në rast të konstatimit të veprimeve në kundërshtim me ligjin;
- k. c) mbështet punën e strukturave kompetente të bashkisë;
- l. ç) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë parqet, lulishtet dhe zonat e gjelbëruara;
- m. d) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë tregjet publike;
- n. dh) bazuar në vendimmarrjen e kryetarit të bashkisë, mund të administrojë këndet e lojërave, terrenet sportive, bibliotekat, shtëpitë dhe klubet e rinisë;
- o. e) përgatit dhe i propozon kryetarit të bashkisë planin për investimet nën juridiksionin e saj territorial, si dhe mbikëqyr, pas miratimit, zbatimin e tyre, sipas ligjit;
- p. ë) propozon, sipas ligjit, emërtimin e rrugëve, shesheve, institucioneve dhe objekteve që janë nën juridiksionin e saj territorial;
- q. f)mbështet, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryetarëve e të kryesive të fshatrave;
- r. g) i propozon kryetarit të bashkisë dhënien e titujve të nderit dhe stimujve për personat nën juridiksionin e saj territorial;
- s. gj)propozon marrjen e nismave në dobi të komunitetit me mundësi të barabarta dhe përfitime nga të gjithë brenda juridiksionit të saj territorial;
- h) kryen çdo funksion tjetër të deleguar nga kryetari i bashkisë